



ALBANIAN UNIVERSITY

RREGULLORE

“PËR INTEGRITETIN KËRKIMOR-SHKENCOR, PRAKTIKAT E MIRA
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ANTIPLAGJIATURËN NË ALBANIAN
UNIVERSITY”

Miratohet

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Julian Fink

Tiranë, më 23. 05. 2026



RREGULLORE

“PËR INTEGRITETIN KËRKIMOR-SHKENCOR, PRAKTIKAT E MIRA KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ANTIPLAGJIATURËN NË ALBANIAN UNIVERSITY”

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	3
Neni 1 - Objekti dhe qëllimi	3
Neni 2 - Baza ligjore	3
Neni 3 - Fusha e veprimit	4
Neni 4 - Përkufizime	4
Neni 5 - Parime themelore	5
Neni 6 - Detyrime të përgjithshme	5
KREU II - STANDARDET DHE PRAKTIKAT E MIRA KËRKIMORE-SHKENCORE	6
Neni 7 - Autorësia	6
Neni 8 - Botimi dhe shpërndarja	6
Neni 9 - Redaktimi kolegjal dhe vlerësimi	6
Neni 10 - Plagjiatura dhe citimet	6
Neni 11 - Administrimi i të dhënave kërkimore	7
Neni 12 - Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialitetit	7
Neni 13 - Miratimi etik	8
Neni 14 - Përdorimi i inteligjencës artificiale	8
KREU III - SHKELJET E INTEGRITETIT KËRKIMOR-SHKENCOR	8
Neni 15 - Shkeljet e rënda dhe shkeljet e lehta	8
Neni 16 - Proporcionaliteti	9
KREU IV - SINJALIZIMI DHE SHQYRTIMI PARAPRAK	9
Neni 17 - Sinjalizimi	9
Neni 18 - Mbrojtja e ofruar dhe akuzat në keqbesim	10
Neni 19 - Shqyrtimi paraprak	10
Neni 20 - Masat e përkohshme	10
KREU V - PROCEDURA E VERIFIKIMIT	11
Neni 21 - Fillimi dhe përfundimi i verifikimit	11
Neni 22 - Trupa Verifikuese	11
Neni 23 - Të drejtat e personit të sinjalizuar	11
Neni 24 - Zhvillimi i verifikimit	11
Neni 25 - Relacioni i verifikimit	12

KREU VI - VENDIMMARRJA	12
Neni 26 - Organet kompetente	12
Neni 27 - Masat ndreqëse dhe masat e tjera	12
Neni 28 - Sanksionet ndaj personelit	13
Neni 29 - Masat disiplinore	13
KREU VII - MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE	13
Neni 30 - Konfidencialiteti	13
Neni 31 - Të dhënat dhe arkivimi	13
Neni 32 - Zhvillimi institucional	14
KREU VIII - DISPOZITA TË FUNDIT	14
Neni 33 - Interpretimi i Rregullores	14
Neni 34 - Dispozita tranzitore	14
Neni 35 - Hyrja në fuqi	14

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton parimet, standardet, përgjegjësitë dhe procedurat që lidhen me integritetin kërkimor-shkencor dhe praktikën e mira kërkimore-shkencore në Albanian University (AU).
2. Rregullorja ka për qëllim të nxisë veprimtari kërkimore të qëndrueshme, të ndershme, profesionale, të përgjegjshme dhe transparente, si dhe të rregullojë trajtimin e shkeljeve të dyshuara të integritetit kërkimor-shkencor.
3. Kjo Rregullore zbatohet pa cenuar parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm, Statutit, Rregullores së Përgjithshme dhe Kodit të Etikës së AU-së, rregulloreve të tjera të brendshme dhe marrëdhënieve të punës.

Neni 2 Baza ligjore

1. Kjo Rregullore mbështetet në:
 - a) ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - b) ligjin nr. 109/2024 “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”;
 - c) Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM-në nr. 824, datë 24.12.2021, të ndryshuar;
 - d) Kodin kombëtar të Etikës në Shkencë dhe Kërkimin Shkencor, miratuar me VKM-në nr. 831, datë 30.12.2025;

- e) VKM-në nr. 777, datë 26.12.2018 “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, të ndryshuar;
- f) legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e autorit, pronësinë intelektuale, marrëdhëniet e punës, dhe kur është rasti, studimeve klinike dhe atij në fushën e shëndetësisë;
- g) Statutin, Rregulloren e Përgjithshme, Kodin e Etikës dhe akte të tjera të brendshme të AU-së;
- h) standaret e njohura europiane dhe ndërkombëtare të integritetit në kërkim shkencor, përfshirë Kodin Europian të Sjelljes për Integritetin në Kërkimin Shkencor (ALLEA), të rishikuar.

Neni 3 Fusha e veprimit

1. Kjo Rregullore gjen zbatim për:
 - a) anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme;
 - b) personelin akademik me orientim kërkimor dhe personelin ndihmësakademik;
 - c) studentët e regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e ciklit të tretë të studimeve;
 - d) studentët e përfshirë në veprimtari kërkimore nën mbikëqyrje ose udhëheqje, punime diplome, disertacione, publikime, projekte, studime klinike, ose vepra të tjera shkencore;
 - e) bashkëpunëtorë të jashtëm të cilët marrin pjesë në veprimtari kërkimore të AU-së me anë të kontratës, marrëveshje projekti, përkatësie, ose sipas legjislacionit të zbatueshëm.
2. Për subjektet e parashikuara në gërmat “c” dhe “d” të pikës 1, Rregullorja zbatohet kryesisht për veprimtari dhe produkte të lidhura me kërkimin shkencor. Shkeljet akademike gjatë detyrave të kursit ose provimeve trajtohen sipas akteve të brendshme, përveç kur sjellja përbën çështje të integritetit kërkimor-shkencor.

Neni 4 Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:
 - a) **“Integritet kërkimor-shkencor”**, është ndjekja e parimeve të besueshmërisë, ndershmërisë, respektit, përgjegjshmërisë dhe transparencës përgjatë planifikimit, zhvillimit, mbikëqyrjes, vlerësimit, publikimit dhe shpërndarjes së punës kërkimore;
 - b) **“Shkelje të integritetit kërkimor-shkencor”**, përfshijnë fabrikimin, falsifikimin, plagjiaturën, ose shkelje të tjera të rënda të integritetit kërkimor-shkencor, të kryera qëllimisht, me vetëdije, ose nga pakujdesia.
 - c) **“Fabrikimi”**, është sajesa e të dhënave, rezultateve, pjesëmarrësve, burimeve, të dhënave arkivore, dokumentacionit ose gjetjeve, duke i paraqitur si të vërteta.
 - d) **“Falsifikimi”**, është manipulimi i materialeve kërkimore, proceseve, imazheve, të dhënave, analizave ose rezultateve, në mënyrë që arkivi kërkimor të mos pasqyrojë më me saktësi punën e kryer.
 - e) **“Plagjiatura”**, është paraqitja e qëllimshme, me vetëdije, ose nga pakujdesia, e ideve, fjalëve, të dhënave, imazheve, metodave, ose kontributit intelektual të dikujt tjetër si të vetin, pa deklarin e duhur.
 - f) **“Auto-plagjiatura”**, është ripërdorimi i padeklaruar qëllimisht, me vetëdije, ose nga pakujdesia, i pjesëve madhore të punimit vetjak të shpërndarë më parë, në mënyrë të atillë që krijon përshtypjen e risisë ose shumësisë së publikimeve.
 - g) **“Autorësia”**, është njohja ose deklarimi i personit, i cili ka dhënë kontribut intelektual të konsiderueshëm për një punim kërkimor dhe i cili pranon përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

- h) **“Konflikt i interesit”**, është çdo interes financiar, profesional, personal, institucional, ose interes tjetër, që mund të ndikojë në mënyrë të padrejtë, ose ka arsye të duket se ndikon, në objektivitetin dhe integritetin e punës kërkimore ose vendimmarrjes së lidhur.
- i) **“Të dhëna kërkimore”**, janë informacione, këqyrje, matje, burime, imazhe, kode, pyetësorë, shënime laboratorike, materiale biologjike, baza të dhënash, ose materiale të tjera të krijuara, mbledhura, përpunuara ose përdorura për qëllime kërkimore.
- j) **“Mjet i IA-së”**, është çdo program në një sistem ose model llogaritës me aftësi krijimi, analizimi, ndërhyrjeje, interpretimi, ose mbështetjeje në prodhimin e fjalëve, imazheve, të dhënave, kodit, ose veprave të tjera të lidhura me kërkimin shkencor.
- k) **“Pjesëmarrës në studim”**, është çdo person, grup, pacient, organizatë, kafshë, material biologjik, grup të dhënash, ose subjekt tjetër i përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në studime shkencore.
- l) **“Arkivi shkencor”**, është tërësia e informacionit që dokumenton planifikimin, zhvillimin, analizën, raportimin, publikimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e punës kërkimore dhe rezultateve të saj.
- m) **“Program kontrolli ngjashmërie”**, janë programe të përdorura për të identifikuar ngjashmëri ose mbivendosje të përmbajtjes së shkruar. Rezultatet e programit shërbejnë si indicie, por të vetme nuk provojnë plagjiaturën ose shkelje të tjera.
- n) **“Mjet kontrolli të IA-së”**, janë programe që kanë për qëllim të vlerësojnë me përafërsi nëse materiali është krijuar nëpërmjet inteligjencës artificiale. Rezultatet e programit shërbejnë si indicie dhe nuk përbëjnë provë të pakundërshtueshme.
- o) **“Kodi i Etikës së AU-së”**, është Kodi i Etikës i Albanian University në fuqi, miratuar nga Këshilli i Etikës në përputhje me parashikimet statutores, i cili përmban masat dhe procedurat e lidhura me çështjet disiplinore në AU.
- p) **“Kodi kombëtar i Etikës”**, është Kodi i Etikës në Shkencë dhe Kërkimin Shkencor, miratuar me VKM-në nr. 831, datë 30.12.2025. Ky akt përcakton standarde kombëtare të etikës kërkimore-shkencore dhe nuk delegon, në vetvete, kompetencë disiplinore tek organet e AU-së.
- q) **“Organi kompetent”**, është organi i AU-së, autoriteti i AU-së, organi publik, organi profesional, botuesi, financuesi, ose çdo organ tjetër i njohur ligjërisht, i cili sipas legjislacionit të zbatueshëm, Statutit, Rregullores së Përgjithshme dhe Kodit të Etikës së AU-së, rregulloreve të tjera të brendshme, marrëdhëniet e punës, kontratës, ose procedurës së detyrueshme, ka të drejtën e vendimmarrjes mbi masat ndreqëse, akademike, disiplinore, të punësimit, kontraktore, ose masat e tjera. Organi ose autoriteti që vepron në zbatim të kësaj Rregulloreje nuk do të ushtrojë kompetenca që nuk i janë ngarkuar me aktin përkatës ligjor ose institucional.

Neni 5 Parimet themelore

1. Puna kërkimore në AU udhëhiqet nga:
 - a) besueshmëria në projektim, metodologji, analizë dhe raportim;
 - b) ndershmëria në mbledhjen, përdorimin, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave;
 - c) respekti për pjesëmarrësit, pacientët, studentët, kolegët, kafshët, mjedisin dhe pronësinë intelektuale;
 - d) përgjegjshmëria për cilësinë, transparencën dhe pasojat e punës kërkimore.

Neni 6 Detyrime të përgjithshme

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje kanë detyrimet e mëposhtme:
 - a) të ndjekin standardet profesionale, ligjore, etike dhe disiplinore;

- b) të raportojnë me saktësi metodat, burimet, të dhënat, kufizimet dhe gjetjet;
- c) të mbajnë dokumentacion shkencor të përshtatshëm;
- d) të deklarojnë me korrektësi autorët, kontribuesit, burimet dhe financimin;
- e) të deklarojnë konflikte të interesit;
- f) të mbrojnë të dhënat personale dhe konfidenciale;
- g) të sigurojnë miratimin etik, sipas rastit;
- h) të shfaqin bashkëpunim në procedurat institucionale që lidhen me integritetin kërkimor-shkencor.

KREU II STANDARDET DHE PRAKTIKAT E MIRA KËRKIMOR-SHKENCORE

Neni 7 Autorësia

1. Autorësia mbështetet në kontribut madhor intelektual dhe pranim të përgjegjësisë për punën kërkimore.
2. Ndalohen praktikat si dhurimi ose shitja e autorësisë, fshehja e autorësisë, autorësia fiktive, përjashtimi i pajustificuar i kontribuesve dhe autorësia e imponuar.
3. Kontributi që nuk është në nivelin e autorësisë deklarohet, kur është rasti.

Neni 8 Botimi dhe shpërndarja

1. Rezultatet nga kërkimi raportohen me saktësi, plotësi dhe pa ometime çorientuese.
2. Ndalohen botimi duplikatë, ribotimi çorientues, manipulimi i treguesve të citimeve dhe copëzimi çorientues i veprave shkencore.
3. Gabimet e zbuluara pas shpërndarjes korrigjohen sa më parë.

Neni 9 Redaktimi kolegjal dhe vlerësimi

1. Redaktimi kolegjal (*peer review*), puna redaktuese, mbikëqyrja, shqyrtimi dhe vlerësimi akademik zhvillohen në mënyrë të drejtë, konfidenciale, neutrale, dhe pa keqpërdorur informacion të rezervuar.
2. Udhëheqësit shkencorë nxisin në mënyrë aktive ndërgjegjësimin e kërkuesve dhe studentëve që udhëheqin për standardet e integritetit kërkimor-shkencor, dhe kur është rasti, ngrenë sa më parë shqetësime të mundshme.
3. Çdo konflikt interesi deklarohet. Dorëheqja është e nevojshme kur ka arsye që paanshmëria të vihet në dyshim.

Neni 10 Plagjiatura dhe citimet

1. Plagjiatura përbën shkelje të rëndë kur është madhore ose kur mund të krijojë çorientim sa i përket autorësisë, risisë, burimit, ose kontributit akademik.
2. Parandalimi i plagjiaturës arrihet nëpërmjet trajnimit, udhëzimit për shkrimin akademik dhe citimin, udhëheqjen e përgjegjshme, përdorimin e duhur të programeve të kontrollit të

- ngjashmërisë, si dhe orientime të qarta mbi përdorimin etik të mjeteve IA në kërkimin shkencor dhe shkrimin akademik.
3. Programet e kontrollit të ngjashmërisë mund të përdoren si mjet parandalues dhe edukues përpara dorëzimit të mikrotezave, disertacioneve, dorëshkrimeve, raporteve të projektit ose veprave të tjera kërkimore. Raportet e ngjashmërisë interpretohen nga personel i kualifikuar, por të vetme nuk provojnë plagjiaturën ose shkelje të tjera.
 4. Gjatë citimit, gabimet njerëzore, të vogla, teknike ose të parëndësishme, si rregull trajtohen nëpërmjet korrigjimit, sqarimit, udhëzimit dhe trajnimit.
 5. Kur një rast i mundshëm plagjiature konstatohet *përpara* dorëzimit formal ose botimit të veprës shkencore, autorit ose studentit i jepet mundësia për të rishikuar, korrigjuar dhe deklaruar drejt burimet, përveç kur rrethanat dëshmojnë çorientim të qëllimshëm, shkelje të përsëritur, ose shkelje të tjera të integritetit kërkimor-shkencor.
 6. Kur një rast i mundshëm plagjiature konstatohet *pas* dorëzimit, publikimit, ose shpërndarjes së veprës shkencore, çështja trajtohet në përputhje me procedurat e parashikuara në krerët III e vijues të kësaj Rregulloreje.
 7. Kur vërtetohet plagjiatura ose auto-plagjiatura, AU-ja në radhë të parë ndërmerr masa ndreqëse për të mbrojtur integritetin e arkivit shkencor, përfshirë korrigjimin, rishikimin, tërheqjen ose veprime të tjera të përshtatshme, pa cenuar zbatimin e masave disiplinore që mund të caktohen sipas kësaj Rregulloreje.
 8. Veprimet e mëposhtme nuk përbëjnë, në vetvete, plagjiaturë:
 - a) përdorimi i njohurive të gjithëpranuara, terminologjisë standarde, formulimeve ligjore ose teknike, ose metodave të njohura;
 - b) citimi i duhur, perifrazimi, përmbledhja, kritika, ose diskutimi shoqëruar me citimin e duhur;
 - c) krijimi i pavarur i veprave të ngjashme ose që mbivendosen;
 - d) puna e lejuar në grup;
 - e) mbështetje redaktuese, teknike, gjuhësore ose formatimi, të cilat nuk shkaktojnë çorientim mbi autorësinë;
 - f) ripërdorimi i lejuar i veprave vetjake të mëparshme, kur nuk është madhor, çorientues, ose që paraqitet si punim i ri dhe origjinal.

Neni 11

Administrimi i të dhënave kërkimore

1. Të dhënat kërkimore mblidhen, ruhen, përpunohen, mbahen, ndahen, arkivohen dhe asgjësohen në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, standardet etiko-disiplinore, dhe aktet e brendshme të AU-së.
2. Kërkuesit shkencorë sigurojnë saktësi, gjurmueshmëri, konfidencialitet dhe mbrojtjen e duhur të të dhënave kërkimore.
3. Pronësia mbi të dhënat, qasja, transferimi, mbajtja dhe përdorimi pas shkëputjes së marrëdhënieve me AU-në rregullohet nga kontrata, marrëveshja e projektit, akti i brendshëm dhe legjislacioni i zbatueshëm.

Neni 12

Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialitetit

1. Përpunimi i të dhënave personale në veprimtarinë kërkimore-shkencore është në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Të dhënat sensitive, përfshirë ato shëndetësore, klinike, biometrike, gjenetike, ose të dhënat që lidhen me grupe të ndjeshme, përfitojnë mbrojtje të përforcuar.
3. Qasja në materiale kërkimore konfidenciale kufizohet te personat e autorizuar.

Neni 13

Miratimi etik

1. Kur studimi përfshinë pjesëmarrës qenie njerëzore, pacientë, grupe të ndjeshme, të dhëna personale, material biologjik, kafshë, ose në rastin e studimeve klinike a të lidhura me shëndetin, ose çështje të tjera të ndjeshme nga ana etike, nevojitet shqyrtim dhe miratim etik paraprak.
2. Puna kërkimore që kërkon miratim etik nuk mund të fillojë para marrjes së këtij miratimi.
3. Çdo ndryshim material në një projekt kërkimor të miratuar paraqitet për shqyrtim të mëtejshëm, kur është rasti.

Neni 14

Përdorimi i inteligjencës artificiale

1. Mjetet e IA-së mund të përdoren në kërkim shkencor vetëm kur kjo bëhet në mënyrë transparente, të përgjegjshme, të ligjshme dhe të verifikueshme.
2. Përdorimi i gjerë i mjeteve të IA-së për hartim, përkthim, analizë, kodim, krijim imazhesh, përpunim të dhënash ose interpretim, deklarohet kur i shërben transparencës, riprodhimit ose vlerësimit.
3. Për qëllimet e pikës 2 të këtij neni dhe për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm nga studentët dhe udhëheqësit, AU-ja nxjerr një formular standard deklarimi për përdorimin e mjeteve të IA-së në kërkimin shkencor dhe shkrimin akademik.
4. Ndalohet përdorimi i mjeteve të IA-së për të fabrikuar burime, citime, të dhëna, imazhe, gjetje, redaktim kolegjal, ose autorësi.
5. Kërkuesi shkencor, autori dhe studenti mbajnë përgjegjësi të plotë për saktësinë, origjinalitetin, ligjshmërinë dhe integritetin e çdo veprë të krijuar me mbështetjen e IA-së.
6. Udhëheqësi shkencor mbështet studentin në përdorimin e duhur të mjeteve të IA-së në punimet që udhëheq, në përputhje me mjetet dhe udhëzimet që AU-ja vë në dispozicion. AU-ja siguron mjetet dhe udhëzimet e nevojshme për këtë qëllim.

KREU III

SHKELJET E INTEGRITETIT KËRKIMOR-SHKENCOR

Neni 15

Shkeljet e rënda dhe shkeljet e lehta

1. Shkeljet e rënda të integritetit kërkimor-shkencor përfshijnë sjelljet e mëposhtme:
 - a) fabrikimin;
 - b) falsifikimin;
 - c) plagjiaturën;
 - d) auto-plagjiaturën e rëndë dhe të padeklaruar;
 - e) fshehjen, asgjësimin ose manipulimin e të dhënave kërkimore;
 - f) kryerjen e studimit pa miratimin etik të nevojshëm;
 - g) shkeljen e rëndë të rregullave të mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit;
 - h) keqpërdorimin e informacionit të rezervuar gjatë redaktimit ose vlerësimit kolegjal;
 - i) konfliktin e rëndë të interesit, të padeklaruar;
 - j) keqpërdorimin e qëllimshëm të mjeteve të IA-së për çorientim;
 - k) hakmarrjen ndaj personave që raportojnë shqetësime në mirëbesim.
2. Shkeljet e lehta të integritetit kërkimor-shkencor përfshijnë sjelljet e mëposhtme:

- a) gabimet e vogla ose të paqëllimshme në citime dhe referenca;
- b) deklarimin e paplotë të kontribuesve, burimeve të financimit, ose përkatësisë institucionale, pa qëllim çorientues;
- c) citimin e tepërt, por në mënyrë sporadike, të publikimeve vetjake ose ato të të njëjtit autor, koleg, ose grupi kërkimor, pa pasur si qëllim manipulimin e treguesve të citimit;
- d) ripërdorimin e kufizuar të veprave vetjake të mëparshme, kur nuk përbën auto-plagjiaturë;
- e) mbajtja e dokumentacionit shkencor të paplotë, kur nuk ndikon në besueshmërinë e veprës;
- f) mosdeklarimi i përdorimit të kufizuar të mjeteve të IA-së, kur nuk ndikon në risinë, saktësinë dhe integritetin e veprës;
- g) devijimi i lehtë ose në raste të veçuara, nga procedurat shkencore ose praktikat e mira kërkimore-shkencore, kur nuk ka ardhur dëm madhor.

Neni 16 Proporcionaliteti

1. Çdo masë e marrë në zbatim të kësaj Rregulloreje do të jetë proporcionale me elementet e mëposhtme:
 - a) rëndësinë e shkeljes;
 - b) shkallën e dashjes, dijenisë, pakujdesisë ose neglizhencës;
 - c) ndikimi akademik, institucional, ligjor ose publik;
 - d) përsëritja ose fshehja e shkeljes;
 - e) nëse shkelja është ndrequr vullnetarisht ose jo;
 - f) rrethana të ndryshme lehtësuese ose rënduese;
 - g) kur, për shkak të kalimit të kohës, është kufizuar ndjeshëm mundësia e AU-së për të konstatuar faktet në mënyrë të drejtë.

KREU IV SINJALIZIMI DHE SHQYRTIMI PARAPRAK

Neni 17 Sinjalizimi

1. Çdo person mund të sinjalizojë, me shkrim, shkelje të pretenduara të integritetit kërkimor-shkencor, drejtuar Zyrës së Rektorit.
2. Sinjalizimi duhet të identifikojë sjelljen, personat e përfshirë, veprën shkencore në fjalë, provat shoqëruese, dhe urgjencën kur është rasti. Provat shoqëruese duhet të përmbajnë informacion të besueshëm dhe të verifikueshëm.
3. Sinjalizimet anonime mund të merret parasysh kur janë mjaftueshëm konkrete dhe të besueshme.
4. Sinjalizimi mund të paraqitet pavarësisht kohës që ka kaluar nga shkelja e pretenduar. Vjetërsia e shkeljes së pretenduar nuk pengon çeljen e shqyrtimit paraparak. Kur për shkak të kalimit të kohës, është kufizuar ndjeshëm mundësia e AU-së për të konstatuar faktet, kjo do të vlerësohet sipas nenit 16 të kësaj Rregulloreje, përfshirë në fazën e shqyrtimit paraparak sipas nenit 19. Mosparashkrimi sipas kësaj Rregulloreje nuk ndikon te afate të tjera parashkrimi, afate procedurale ose kufizime ligjore të zbatueshme për masat disiplinore, të punësimit, kontraktore, të statusit të studentit ose gjyqësore.

Neni 18
Mbrojtja e ofruar dhe akuzat në keqbesim

1. AU-ja do të mbrojë, brenda kufijve ligjorë, personat që raportojnë shqetësime në mirëbesim dhe ata që marrin pjesë në procedurat sipas kësaj Rregulloreje. Në këtë rast zbatohet, për aq sa është e mundur, legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve.
2. Ndalohet rreptësisht hakmarrja ndaj sinjalizuesve.
3. Paraqitja e akuzave që dihen se janë të rreme, dashakeqe, ose akuzat në keqbesim, mund të përbëjnë gjithashtu shkelje.

Neni 19
Shqyrtimi paraprak

1. Shqyrtimi paraprak përcakton çështjet e mëposhtme:
 - a) nëse çështja hyn në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje;
 - b) nëse ka baza të mjaftueshme për të vijuar me procedurën;
 - c) nëse nevojiten masa urgjente mbrojtëse ose ndreqëse në përputhje me nenin 20;
 - d) nëse çështja duhet t'i kalojë për kompetencë një tjetër organi.
2. Shqyrtimi paraprak kryhet jo më vonë se 20 ditë pune nga marrja e sinjalizimit, me mundësi zgjatjeje vetëm një herë me 10 ditë pune, për shkaqe të arsyeshme.
3. Procesi i shqyrtimit paraprak nuk synon të përcaktojë përgjegjësinë e individit.

Neni 20
Masat e përkohshme

1. Kur gjatë shqyrtimit paraprak konstatohet nevoja për masa urgjente mbrojtëse ose ndreqëse, Rektori mund të urdhërojë caktimin e masave të përkohshme që shkojnë në përpjestim me rrezikun.
2. Masat e përkohshme në kuptim të pikës 1 të këtij neni, përfshijnë, ndër të tjera:
 - a) pezullimin e përkohshëm të dorëzimit, publikimit, ose aplikimit për financim;
 - b) heqjen e përkohshme të përgjegjësive mbikëqyrëse, redaktuese ose vlerësuese;
 - c) kufizimin e përkohshëm të qasjes në të dhëna, materiale ose ambiente kërkimore.
3. Masat e përkohshme kanë natyrë paraprake. Ato nuk nënkuptojnë vërtetimin e shkeljes dhe as paragjykojnë mënyrën e përfundimit të verifikimit.
4. Masat e përkohshme rishqyrtohen brenda 30 ditëve nga caktimi i tyre, dhe në rast se vlerësohen të panevojshme, hiqen.
5. Personi i sinjalizuar informohet sa më shpejt që të jetë e mundur mbi masat e përkohshme dhe shkaqet për caktimin e tyre, brenda kufijve të ligjshëm të konfidencialitetit.
6. Kur Rektori, një autoritet vendimmarrës, ose anëtar i një organi të përfshirë ndodhen përpara konfliktit të interesit, personi nuk merr pjesë në atë veprim procedural. Në këtë rast, çështja i kalon autoritetit kompetent zëvendës sipas Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të AU-së, ose vendimmarrjes në atë rast.

KREU V

PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Neni 21

Fillimi dhe përfundimi i verifikimit

1. Kur nga shqyrtimi paraprak konstatohen të dhëna të mjaftueshme, fillon zyrtarisht procesi i verifikimit.
2. Verifikimit kryhet nga një Trupë Verifikuese e ngritur sipas nenit 22 të kësaj Rregulloreje.
3. Në përfundim të veprimeve verifikuese, Trupa Verifikuese e kalon çështjen për shqyrtim, së bashku me relacionin e verifikimit sipas nenit 25, sipas rastit:
 - a) te Këshilli i Etikës i AU-së, për vendimmarrje mbi masat disiplinore brenda kompetencave statutore;
 - b) organi kompetent, për masat ndreqëse ose akademike jodispline.

Neni 22

Trupa Verifikuese

1. Procesi i verifikimit zhvillohet nga një trupë e pavarur që gëzon ekspertizën e duhur, e cila caktohet nga Rektori.
2. Anëtarët e trupës deklarojnë konfliktin e interesit dhe dorëhiqen kur ka arsye që paanshmëria të vihet në dyshim.
3. Kur kërkohet ekspertizë e veçantë, mund të këshillohen edhe ekspertë të jashtëm.
4. Trupa Verifikuese vepron me rol faktmbledhës në përputhje me këtë kre dhe nuk ushtron kompetenca disiplinore që i përkasin Këshillit të Etikës ose tjetër organi kompetent.

Neni 23

Të drejtat e personit të sinjalizuar

1. Personi i sinjalizuar ka të drejtat e mëposhtme:
 - a) të njoftohet për shkeljen që i atribuhohet;
 - b) të marrë kohë të arsyeshme për të shprehur qëndrimin;
 - c) të kërkojë përfaqësim ligjor në proces;
 - d) të dëgjohet;
 - e) të japë shpjegime dhe paraqesë prova;
 - f) të njihet me provat kryesore të përdorura, brenda kufijve ligjorë të konfidencialitetit;
 - g) të presë një përfundim të arsyetuar;
 - h) të paraqesë ankim, në përputhje me rregullimet statutore.

Neni 24

Zhvillimi i verifikimit

1. Procesi i verifikimit do të jetë i drejtë, konfidencial dhe i pavarur.
2. Verifikimet përfundojnë brenda 90 ditëve nga fillimi i tyre sipas nenit 21, me mundësi zgjatjeje nga Rektori për një kohë deri në 45 ditë, për shkaqe të arsyeshme. Vendimi i zgjatjes së afateve të verifikimit i njoftohet personit të sinjalizuar.
3. Trupa ka të drejtë të kërkojë administrimin e dokumentacionit, të marrë deklaratat të personave të lidhur, të këshillohet me ekspertë, dhe të shqyrtojë vepra shkencore, të dhëna, komunikime, raporte programesh, ose materiale të tjera të ngjashme.

4. Raportet e ngjashmërisë, raportet e kontrollit të IA-së, ose vlerësimet e automatizuara mund të mbështesin shqyrtimin në çdo fazë, por të vetme nuk shërbejnë për të vërtetuar shkeljen.
5. Gjetjet mbështeten në prova konkrete dhe zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në çështje të ngjashme.

Neni 25 **Relacioni i verifikimit**

1. Relacioni i verifikimit i përcjellë nga Trupa Verifikuese përmban:
 - a) shkeljen e atribuar;
 - b) rrethanat e faktit;
 - c) provat e administruara;
 - d) standardet e zbatueshme;
 - e) nëse është gjetur shkelje në rastin konkret;
 - f) rëndësinë e shkeljes;
 - g) rekomandime për masa ndreqëse, akademike, institucionale ose disiplinore.

KREU VI **VENDIMMARRJA**

Neni 26 **Organet kompetente**

1. Këshilli i Etikës, brenda kompetencave të tij, shqyrton çështje që lidhen me etikën dhe vendos ose i rekomandon autoritetit kompetent të institucionit masa të përshtatshme.
2. Strukturat që veprojnë në zbatim të kësaj Rregulloreje mund të rekomandojnë masa, por pa tejkaluar kompetencat e përcaktuara nga kuadri normativ i AU-së.

Neni 27 **Masat ndreqëse dhe masat e tjera**

1. Masat përfshijnë, sipas rastit:
 - a) ndreqjen, sqarimin, shtjellimin, korrigjimin zyrtar, ose ndryshimin e veprës në fjalë;
 - b) udhëzimin, udhëheqjen, trajnimin ose mbikëqyrjen;
 - c) rishikimin, ridorëzimin, pezullimin ose tërheqjen e veprës;
 - d) ndreqjen e arkivit shkencor;
 - e) rekomandimin që një vepër të mos merret parasysh për qëllime vlerësimi, promovimi, financimi, raportimi, ose qëllime institucionale;
 - f) referimin tek organi kompetent për marrjen e masave disiplinore, të punësimit, kontraktore, akademike ose administrative;
 - g) njoftimin e botuesit, financuesit, institucionit partner, organit publik, urdhrit profesional, ose organeve të tjera të jashtme, në rast se kërkohet nga ligji, kontrata, procedura e detyrueshme ose nevoja madhore institucionale.

Neni 28
Sanksionet ndaj personelit

1. Ndaj subjekteve të parashikuara në nenin 3, pika 1, gërmat “a” dhe “b” të kësaj Rregulloreje, për të cilët është vërtetuar se kanë kryer shkelje të rënda të integritetit kërkimor-shkencor sipas procedurës së Kreut V, zbatohen sanksionet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.
2. Sanksionet e zbatuara në mënyrë proporcionale përfshijnë:
 - a) paralajmërimin me shkrim;
 - b) heqjen e përgjegjësisë mbikëqyrëse, redaktuese ose vlerësuese, për një periudhë kohe që i përgjigjet shkeljes;
 - c) pezullimin e privilegjeve kërkimore, përfshirë qasjen në financim ose mjedise të kërkimit, për një periudhë të caktuar;
 - d) përjashtimin nga mundësia e promovimit, kërkimit të titullit akademik, ose financimit të kërkimit, për një periudhë të caktuar;
 - e) referimin tek organi kompetent për rishikimin, korrigjimin, pezullimin ose revokimin e gradës shkencore, titullit akademik, certifikatës ose vlerësimit, në rastet e lejuara nga ligji dhe sipas procedurës përkatëse;
 - f) referimi te Rektori, në zbatim të një vendimi të Këshillit të Etikës, për marrjen e masave që lidhen me marrëdhëniet e punës.

Neni 29
Masat disiplinore

1. Masat disiplinore që prekin marrëdhëniet e punës, pagën, largimin nga puna, statusin e studentit, gradat shkencore, titujt akademikë dhe certifikatat, si dhe të drejtat ligjore, vendosen vetëm nga organi kompetent dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe institucionale.
2. Masat ndreqëse që lidhen me arkivin shkencor janë të ndryshme nga masat disiplinore ndaj individëve.

KREU VII
MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE

Neni 30
Konfidencialiteti

1. Të gjitha procedurat në zbatim të kësaj Rregulloreje respektojnë konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave personale, objektiviteten dhe mbrojtjen e reputacionit.
2. Informacioni ndahet vetëm me personat ose organet që kanë nevojë të përligjur institucionale për t'u njohur me të.

Neni 31
Të dhënat dhe arkivimi

1. AU-ja mban të sigurt të dhënat për sinjalizimet, vlerësimet, verifikimet, relacionet, vendimet dhe masat.
2. Të dhënat arkivohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat dhe kuadrin e brendshëm.

Neni 32
Zhvillimi institucional

AU-ja mund të përdorë informacion të anonimizuar prej çështjeve për të përmirësuar trajnimin, mbikëqyrjen, politikat, kulturën e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe parandalimin e shkeljeve të mëtejshme.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33
Interpretimi i Rregullores

1. Kjo Rregullore interpretohen në përputhje me aktet dhe standardet në nenin 2 të saj.
2. Për çështjet e patrajuara në mënyrë të veçantë, AU-ja mund të referohet te standardet e njohura europiane dhe ndërkombëtare mbi integritetin kërkimor-shkencor, ALLEA-n, udhërrëfyesi i çështjeve të Komitetit për Etikën në Publikime (COPE), dhe kur është rasti, te Kodi kombëtar i Etikës.

Neni 34
Dispozita tranzitore

1. Shkeljet e pretenduara që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, vlerësohen sipas rregullave në fuqi në kohën e kryerjes së tyre. Procedurat e parashikuara në këtë Rregullore zbatohen për çdo çështje të çelur pas hyrjes së saj në fuqi, në përputhje me nenin 17, pika 4 të Rregullores.
2. Për shkeljet e pretenduara që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, zbatohen vetëm sanksionet e parashikuara në aktet në fuqi në kohën e kryerjes së tyre. Kur kjo Rregullore parashikon masa më të favorshme, gjejnë zbatim këto të fundit.
3. Masat ndreqëse dhe masat e tjera, në kuptim të nenit 27 të Rregullores, gjejnë zbatim pavarësisht kohës që ka ndodhur shkelja e pretenduar.
4. Materialet e mbledhura në mënyrë të ligjshme përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje mund të përdoren nga Trupa Verifikuese. Në këtë rast gjejnë zbatim të drejtat përkatëse të personit të sinjalizuar.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik dhe nënshkrimit të Kryetarit, përveç kur parashikohet ndryshe në vendimin e Senatit.

Miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 57, datë 23.08.2026